



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 28, datë 11.06.2025

PËR NDRYSHIMIN E PIKËS 1, TË VKB-SË NR.11, DATË 30.04.2025 “PËR DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR VAZHDIMIN E PROCEDURËS SË NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË PËRDORIMIT TË SIPËRFAQES PYJORE NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR, NË ZBATIM TË VENDIMIT NR.37, DATË 01.08.2023 TË KKT-SË “PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN RESORT TURISTIK LURA 5, FAZA 3, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM, BASHKIA Durrës”, PËR SHKAK TË NJË GABIMI MATERIAL

Në zbatim të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”, Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr. 1, datë 26.01.2017 “Per mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullësor kombëtar”, VKM nr. 888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”, VKM nr. 1374, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor” i ndryshuar, shkresës së Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit Nr. 1667/1 Prot, datë 12.03.2025 si edhe sipas relacionit të hartuar nga Sektori i Pyjeve dhe Kullotave pranë Drejtorisë Ligjore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:



1. Miratimin e ndryshimit të pikës 1, të VKB-së nr.11, datë 30.04.2025 “Për dhënien e dakordësisë për vazhdimin e procedurës së ndryshimit të kategorisë së përdorimit të

sipërfaqes pyjore nga fondi pyjor kombëtar, në zbatim të vendimit nr.37, datë 01.08.2023 të KKT-së “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin resort turistik Lura 5, faza 3, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës”, për shkak të një gabimi material, si më poshtë vijon:

Dhënien e dakordësisë për vazhdimin e procedurës së ndryshimit të kategorisë së përdorimit të sipërfaqes pyjore prej 8652.45 m² (pronësi private) nga fondi pyjor kombëtar, në zbatim të Vendimit nr.37, datë 01.08.2023 të KKT-së “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin resort turistik Lura 5, faza 3, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Pyjeve dhe Kullotave pranë Drejtorisë Ligjore, Bashkia Durrës

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK DËRRËS

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 12.06.2025





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

BASHKIA DURRESE
18/6/25 6672/8
Nr. PROT.

Nr. 339/18 prot.

Durrës, më 16.06.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.28 datë 11.06.2025 ,” Për ndryshimin e pikës 1 , të VKB-së nr.11, datë 30.04.2025,” Për dhënien e dakortësisë për vazhdimin e procedurës së ndryshimit të kategorisë së përdorimit të sipërfaqes pyjore nga fondi pyjor kombëtar , në zbatim të vendimit nr.37 datë 01.08.2023 të KKT-së,”Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin resort turistik Lura 5, Faza 3, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës” për shkak të një gabimi material”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

